



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.378/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesuese, Faton Ademi dhe Fejzullah Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të procesimit të votave të pa rregullta të ardhura nga Serbia përmes postës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa lejuar ankesa Anr.378/2019, e datës 24.10.2019, e parashtruar nga koalicioni NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën ka kërkuar që të anulohen fletëvotimet si të pa rregullta të ardhura nga Serbia, përmes postës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.378/2019, të parashtruar nga koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën thekson se Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka vepruar në kundërshtim me nenin 4.3 dhe 4.4 të Rregullës Zgjedhore 03/2013, pasi që ka pranuar dërgesa postare në mënyrë të grumbulluara (paketë), gjë që konsiderohet se të gjitha këto vota janë plotësuar në një lokacion në Serbi, dhe nga persona të njëjtë e të proceduara poashtu në grup. Parashtruesi i ankesës më tutje theksojnë se pakot e dorëzuara në postën e Kosovës nr.6 të Prishtinës nuk kanë vulë dhe pullë postare të origjinës, dhe se zarfet e e ardhura nga Serbia kanë dimensione dhe ngjyre të njëjtë, se janë të printuara nga i njëjti printer, se janë plotësuar nga një dorëshkrim dhe se në mes të fletëvotimit ka një shenje të zeze në mes të cila dëshmon për një strukturë unike të fabrikimit të këtyre votave. Me tutje parashtruesi i ankesës i hedh poshtë pretendimet se nuk ka mundësi votimi përmes postes nga Serbia pasi që në raportin e Divizionit të shërbimit të votuesve figurojnë 5 zarfe individuale me fletëvotime të rregullta të cilat kanë mbërritur konform procedurave ligjore. Parashtruesi i ankesës më tutje kërkon nga PZAP, që të kërkojë nga Policia e Kosovës incizimin e momentit të dorëzimit-pranimit të grumbullit të votave të ardhura nga Serbia në postën nr.6 në Prishtinës, ku shihet qartë se këto zarfe nuk kanë vula të origjinës.

Në përgjigje në ankesë KQZ-së, e ka sqaruar anën procedurale të dorëzimit të fletëvotimeve që janë objekt i kësaj çështje juridike.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese se Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka vepruar në kundërshtim me nenin 4.3 dhe 4.4 të Rregullës Zgjedhore 03/2013, pasi që ka pranuar dërgesa postare në mënyrë të grumbulluara (paketë), gjë që konsiderohet se të gjitha këto vota janë plotësuar në një lokacion në Serbi, dhe nga persona të njëjtë e të proceduara poashtu në grup, nuk mund të jenë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se në rastin konkret nga ana e KQZ-së, nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, prandaj paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit, të vendosë lidhur me numërimin e fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosovës, ngase sipas nenit 122 paragrafi 1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht me dispozitën e sipërshtuar. Në këtë rast nga ana e KQZ-së, nuk është marrë vendimi lidhur me keto fletëvotime të ardhura nga votuesit jashtë vendit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, ta paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar edhe pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.378/2019 më datën 25.10.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.